

Data 08.09.2025.

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“Furnizim- Vendosje Pajisje Mjekësore Aparatura Laparoskopie për Kirurgjinë Abdominale dhe
Furnizim-Vendosje pajisja mjekësore CT Scanner,e ndare ne dy lote**

Loti 1 Furnizim- Vendosje Pajisje Mjekësore Aparatura Laparoskopie për Kirurgjinë Abdominale

Loti 2 Furnizim-Vendosje pajisja mjekësore CT Scanner

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pajisje mjekësore: 33100000-1;

FONDI LIMITne total **Loti 1 dhe Loti 2** është: **71,496,666.67** (shtatedhjetë e një milion e katërqind e nentëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pike gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, e konvertuar në Euro: 97.14, sipas kursit të këmbimit të datës **08.09.2025: 736,016.75** (shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëmbëdhjetë pike shtatedhjetë e pesë) **Euro pa TVSH. E ndare ne dy lote;**

Loti 1 Furnizim- Vendosje Pajisje Mjekësore Aparatura Laparoskopie për Kirurgjinë Abdominale

Fondi Limit **Loti 1** është: : **8,330,000.00** (tete milion e treqind e tridhjetë e tre mijë) **lekë pa TVSH,** e konvertuar në Euro: _97.14_, sipas kursit të këmbimit të datës **08.09.2025: _85,752.52**(tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë pike pesëdhjetë e dy) **Euro pa TVSH.**

Loti 2 Furnizim-Vendosje pajisja mjekësore CT Scanner

Fondi Limit **Loti 2** është: **63,166,666.67** (gjashtëdhjetë e tre milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pike gjashtëdhjetë e shtatë)**lekë pa TVSH,** e konvertuar në Euro: 97.14, sipas kursit të këmbimit të datës **08.09.2025:650,264.22** (gjashtëqindë e pesëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër pike njëzet e dy) **Euro pa TVSH.**

Përcaktimi për vlerën e pritshme të mallrave është bërë në zbatim të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 si dhe VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të prokurimit publik”, si dhe referuar Udhëzimit nr. 7 datë 30.07.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së Prokurimit me mjete elektronike.

Kjo procedurë është e ndare vetëm në dy lote për secilin furnizim vendosje pajisje sepse për secilin lot kemi të bëjmë me një pajisje të kompozuar që do të thotë se artikujt e tjerë janë pjesë e sistemit dhe të funksionimit të pajisjes. Nuk bëhet ndarja në shumë lote, pasi prokurimi bashkë nuk e pengon konkurrencën dhe ndarja në shumë lote mund të sjellë artikuj të cilët nuk janë kompatibël ose pjesë e sistemit të pajisjes duke respektuar alternimin funksional të komponenteve respektive të **Aparatura Laparoskopie për Kirurgjinë Abdominale për lotin 1 dhe Pajisjes mjekësore CT Scanner për lotin 2**,

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi”, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

- **Loti 1 Furnizim- Vendosje Aparatura Laparoskopie për Kirurgjinë Abdominale**

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

- a) *vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;*
- b) *çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

1. Pika 2.1.1: Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Autorizim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për tregtimin të pajisjeve mjekësore.**

Pika 2.1.2/a: Operatori ekonomik ofertues **kur është prodhues** duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015** mbi “*Sistemet e menaxhimit të cilësisë*”, me objekt aktiviteti të certifikates për tregtim të pajisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Pika 2.1.2/b: Operatori ekonomik ofertues **kur është prodhues** duhet të paraqesë certifikatën **ISO 13485:2016** mbi “*Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore*”, me objekt aktiviteti të certifikates për tregtim të pajisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Pika 2.1.2/c: Operatori ekonomik ofertues në rastet **kur nuk është prodhues** i artikujve objekt prokurimi, **duhet të paraqesë autodeklarate** që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi, është konform standarteve të cilësisë **ISO 9001:2015** mbi “*Sistemet e menaxhimit të cilësisë*” ose **ISO 13485:2016** mbi “*Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore*”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatorëve ekonomik do të konsiderohet i **permbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit permbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, OE i kualifikuar i pari, duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri. OE i kualifikuar i pari, duhet të paraqesë dokumentacionin e përcaktuar më lart origjinal ose kopje të noterizuar të tij, në zbatim të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*”**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe është e përcaktuar në pikën a) është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter është vendosur në perputhje me pikat 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë tneni e përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në piken 1 të nenit 21 të Nr. 89/2014 "Për Pajisjet Mjekësore" ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: Ministri përgjegjës për shëndetësinë, nëpërmjet strukturës përgjegjëse, pajis me autorizimin për tregtim prodhuesit, vendas ose të huaj, që kanë regjistruar biznesin në Shqipëri, dhe tregtuesit me shumicë e tregtuesit me pakicë të pajisjeve mjekësore",

si dhe

Ky kriter i përcaktuar në pikën a) dhe b) është vendosur në perputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", në të cilën gjejmë të përcaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

4 Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se:

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Pika 2.2.1: Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare të fundit nga data e hapjes së ofertave: 2022; 2023; 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 20% e fondit limit për secilin lot për të cilin oferton të kësaj Proçedure Prokurimi.**

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar, konkretisht mbi vlerën e përcaktuar në piken 2.10.

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera e xhiros minimale do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ne perputhje me piken 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020,”Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne të cilin gjejmë të përcaktuar se:

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet

kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Legjislatori në piken 1 dhe piken 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet se:

Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

Pika2/: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve të kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Referuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure AK ka menduar se vendosja e një vlere minimale të xhiros jo me e vogel se **vlera së fondit limit***, **për të cilën konkurron operatori, është një dëshmi e mjaftueshme për të krijuar** bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatorët Ekonomikë ofertues zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

Neni 43 pika 3

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore **brenda dates 31 mars te vitit pasardhës.**

Vlerësojmë se vërtetimin për xhiron vjetore të certifikuar të vitit 2023, operatorët ekonomikë mund ta disponojnë pas paraqitjes së deklaratës vjetore në organet tatimore, për të cilën kanë patur afat deri më 31.03.2024.

(Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 "Mbi Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare**; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Pika 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të të lotit/loleve që OE Oferton dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes dhe të deklaruara ne organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara ne organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Ky kriter u vendos edhe në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", ne të cilin gjejmë të përcaktuar se:

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel

të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë dhe është ne perputhje me përcaktimet e RRPP nëni 40 pika 4:

“4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.”

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Gjithashtu, vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontrates siç është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nëni 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **jo më te vogël se 20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **minimumi 20% të fondit limit që oferton operatori**, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës).

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontrates siç është parashikuar nga AK.

Pika 2.3.2: Operatori Ekonomik Ofertues duhet të vërtetojë që ka të paktën 2 (dy) Inxhinierë në stafin e tij të trajnuar për aparaturen e përcaktuar në lot 2, të cilët do të kryejnë shërbimin e furnizim - vendosjes së pajisjes objekt prokurimi, riparimin apo ndërrimin e pjesëve të këmbimit dhe trajnimin e personelit për përdorimin e pajisjeve objekt prokurimi.

Për këtë OE duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese për secilin nga stafi më sipër:

- CV-në e inxhinjerit;
- Diplomë e inxhinjerisë;

Çertifikatat/dëshmitë e trajnimit për pajisjet objekt prokurimi, lëshuar nga kompania prodhuese ose ekuivalentet e këtyre çertifikimeve lëshuar nga autoritete të autorizuar/çertifikuara për dhënien e tyre,

- Kontratë pune/ shërbimi e vlefshme.

***Shënim:** Ky kriter në fazën e ofertimit të operatorëve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, OE i kualifikuar i pari, duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri. OE i kualifikuar i pari, duhet të paraqesë dokumentacionin e përcaktuar më lart origjinal ose kopje të noterizuar të tij, në zbatim të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësura me origjinalin.”

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Më konkretisht, në nenin 40, pika 5/b dhe c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, përcaktohet:

Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Personeli i Operatorit ekonomik i nevojitet Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar realizimin e plotë të objektit të këtij prokurimi.

(Shënim - Specifikoni proceset, veprimtaritë apo shërbimet që kërkohen për realizimin e kontratës së furnizimit të mallrave, si dhe numrin e punonjësve të nevojshëm në çdo rast, bazuar në analizën e kryer).

Gjithashtu, argumentimi i Komisionit Ad-Hoc: Eshte menduar stafi minimal prej 2 inxhinjera te nevojshëm për realizimin e prokurimit, pasi me **këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së Kontratës, ofrimi i shërbimit dhe mundësia e pjesëmarrjes në ofertim e sa më shumë Operatorëve Ekonomikë.**

Shënim: Autoriteti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1.

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

Pika 2.4.1: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga prodhuesi (MAF) / ose / Autorizim nga Distributori i Autorizuar (DAF) (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), për të garantuar mirëmbajtjen cilësore, të sigurtë dhe pjesë origjinale të pajisjeve mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi. Autorizimi të jetë i vlefshëm në hapjen e ofertave dhe gjatë zbatimit të Kontratës. Autorizimi duhet të jetë origjinal i përkthyer dhe/ose fotokopje e noterizuar.

Argumentim: Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku eshte e cituar: 5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues(ref. Vendimit te KPP nr. 353/2014).

Si dhe, gjithashtu ky kriter u vendos ne mbështetje te Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Date 20.03.2018 te Agjensise se Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentet e tenderit te procedurave te prokurimit publik”, dhe me qëllim zotërimin e reputacionit dhe besueshmërisë për

zbatimin e kontratës. Afati i vlefshmërisë së autorizimit vendoset në përputhje me kohëzgjatjen e MK. Keto kërkesa dhe vecanerisht lidhja me distributorin, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës, pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

Pika 2.4.2:

a) Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë një **deklarate ku të percaktohet kompania prodhuese, vendi i origjines dhe certifikimet e produkteve objekt prokurimi, si dhe**

b) Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës të deklarojë se **Garancia të paktën 2 (dy) vite** nga data e instalimit dhe vendosjes në funksion të plotë të pajisjes si dhe se në rast të difektit të ndodhur gjatë kësaj periudhe, Operatori Ekonomik Ofertues do të zgjidhë difektin menjëherë dhe nëse duhen pjesë këmbimi për riparim ato të jenë origjinale nga Prodhuesi dhe me garanci jo më pak se 2 (dy) vjet.

c) Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës të deklarojë se artikujt objekt prokurimi, do të jenë të reja dhe të pa përdorura, kompatibel, si dhe të kenë të stampuar markimin CE ose FDA.

d) Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë një **autodeklaratë**, ku të garantojë se me lidhjen e kontratës pajisja do të regjistrohet pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM) në përputhje me ligjin nr. 89, datë 17.07.2014 “Për pajisjet mjekësore” dhe se certifikata e regjistrimit do të vihet në dispozicion të AK.

e) Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë një deklaratë, ku merr përsipër trajnimin e personelit përdorues të pajisjes për të paktën 5 ditë pune, pas instalimit të pajisjes objekt prokurimi.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Argumentim: shkronat a-e të pikës: 2.4.2 janë vendosur në zbatim të: këto kritere janë vendosur nga Komisioni i Përllëgoartjes së Fondit limit dhe Specifikimeve Teknike me shkresën nr. ____ prot., datë _____, si dhe është miratuar nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit që ka specialitetin perkatese në lidhje me kriteret teknike, në përputhje me pikën 4 të nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, “”, neni 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me nenin 36 dhe nenin 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe në Nenin nr.13 të Ligjit Nr. 89/2014 për “Pajisjet Mjekësore” .

Pika 2.4.3.

a. Për artikujt e përcaktuar më poshtë të paraqiten katalogje të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull të përcaktuar në tabelë *(pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, duhet të jenë në gjuhën shqipe ose anglisht).*

b. Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor **(te markuara sipas artikullit)** te percaktuar ne formularin e ofertes.

c. Katalogjet do pranohen ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit si dhe fizikisht gjatë dorëzimit të dokumentacionit nga OE i klasifikuar fitues.

Paraqitja e katalogjeve per te gjithë artikujt qe jane objekt prokurimi, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perpuethshmerise se paisjeve mjekesore qe operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike te percaktuara ne DST ne Shtojcen 6.

Pika 2.4.4. Ofertuesi duhet te paraqese nje autodeklarate ku deklaron se pajisjet do te jene te shoqeruara me manualin e perdorimit, manualin e vendosjes sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe manualin e servisit/sherbimit.

OE duhet të paraqesi deklarata se pajisjet do te jene te shoqeruara me manualin e perdorimit, manualin e vendosjes sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe manualin e servisit/sherbimit, eshte kerkuar ne menyre qe pajisjet mjekesore te perdoren dhe te mirembahen nga stafi mjekesor sipas rekomandimeve te prodhuesit ne menyre qe te shmangen cdo lloj problematike qe mund te lind nga perdorimi ne menyre jo korrekte i ketyre pajisjeve.

Argumentimi: Pika 2.4.3. dhe Pika 2.4.4. eshte vendosur nga anetari i Njesise se Prokurimit qe ka specialitet perkates ne lidhje me kriteret teknike si dhe eshte ne perputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se:[...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].*

Paraqitja e katalogjeve per te gjithë artikujt qe jane objekt prokurimi, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perpuethshmerise se paisjeve mjekesore qe operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike te percaktuara ne DST ne Shtojcen 6.

Pika 2.4.5. Operatori ekonomik duhet te paraqese **oferten teknike**, per pajisjen objekt prokurimi bashke me aksesoret perkates, ne forme te tabelave, ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut te pajisjes / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet perkatese per produktet.

Ne kete kontekst eshte kerkuar dhe oferta teknike, me ane te se ciles do te behet e mundur verifikimi me i sakte i artikujve te ofertuar, specifikimeve te tyre, origjina, konformiteti etj me dokumentacionin mbeshtetes te paraqitur nga ofertuesi.

Argumentimi: Kriteri i vendosur në pikën 2.4.5, eshte vendosur nga anetari i Njesise se Prokurimit qe ka specialitet perkates ne lidhje me kriteret teknike si dhe eshte ne perputhje me **piken 1 te nenit 36 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”**, ne tecileneshte e percaktuar se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi..

Gjithashtu ky kriter është ne perputhje me piken 2 te nenit 40 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Ne kete kontekst është kërkuar dhe oferta teknike, me ane të se ciles do të bëhet e mundur verifikimi me i sakte i artikujve të ofertuar, specifikimeve të tyre, origjina, konformiteti etj me dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga ofertuesi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim për operatorët ekonomikë:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”

Gjithashtu risjellim ne vemendje se:

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.

Në çdo rast, AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më lart, ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Shënim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

- **Loti 2 Furnizim- Vendosje pajisja mjekësore CT Scanner**

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Pika 2.1.1: Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Autorizim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për tregtimin të pajisjeve mjekësore.**

Pika 2.1.2/a: Operatori ekonomik ofertues **kur është prodhues** duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, me objekt aktiviteti të certifikates për tregtim të pajisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit

të tenderit.

Pika 2.1.2/b: Operatori ekonomik ofertues **kur është prodhues** duhet të paraqese çertifikatën **ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, me objekt aktiviteti të certifikates për tregtim të paisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Pika 2.1.2/c: Operatori ekonomik ofertues në rastet **kur nuk është prodhues** i artikujve objekt prokurimi, **duhet të paraqese autodeklarate** që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi, është konform standarteve të cilësive **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose **ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatorëve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, OE i kualifikuar i pari, duhet të paraqese dokumentacionin provues sipas këtij kriteri. OE i kualifikuar i pari, duhet të paraqesi dokumentacionin e përcaktuar më lart origjinal ose kopje të noterizuar të tij, në zbatim të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe është e përcaktuar në pikën a) është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter është vendosur në përputhje në pikat 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë tneni ë përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjiës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe ne piken 1 te nenit 21 te Nr. 89/2014 "Për Pajisjet Mjekësore" ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: Ministri përgjegjës për shëndetësinë, nëpërmjet strukturës përgjegjëse, pajis me autorizimin për tregtim prodhuesit, vendas ose të huaj, që kanë regjistruar biznesin në Shqipëri, dhe tregtuesit me shumicë e tregtuesit me pakicë të pajisjeve mjekësore",

si dhe

Ky kriter i percaktuar ne piken a) dhe b)eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020"Per Prokurimin Publik", ne te cilen gjejme te percaktuar se:

2. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

4 Ky kriter gjen mbështetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" ku percaktohet se:

2. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise".

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Pika 2.2.1: Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare të fundit nga data e hapjes së ofertave: 2022; 2023; 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 20% e fondit limit për secilin lot për të cilin oferton të kësaj Proçedure Prokurimi**.

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar, konkretisht mbi vlerën e përcaktuar në piken 2.10.

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera e xhiros minimale do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Nëse operatorët ekonomikë, per lotin/lotet arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020,”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se:

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Legjislatori në piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohe në Procedurën e Hapur, ku percaktohet se:

Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

Pika2/: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësi ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve të kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Referuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure AK ka menduar se vendosja e nje vlere minimale te xhiros jo me e vogel se **vlera së fondit limit***, **për të cilën konkurron operatori, është një dëshmi e mjaftueshme për të krijuar** bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatorët Ekonomikë ofertues zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

Neni 43 pika 3

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore **brenda dates 31 mars te vitit pasardhës.**

Vlerësojmë se vërtetimin për xhiron vjetore të certifikuar të vitit 2023, operatorët ekonomikë mund ta disponojnë pas paraqitjes së deklaratës vjetore në organet tatimore, për të cilën kanë patur afat deri më 31.03.2024.

(Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohe, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 "Mbi Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare**; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Kapaciteti teknik:

Pika 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të të lotit/loleve që OE Oferton dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes dhe të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Ky kriter u vendos edhe në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të përcaktuar se:

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë dhe është neperputhje me përcaktimet e RRPP neni 40 pika 4:

“4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbytjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Gjithashtu, vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **jo më të vogël se 20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **minimumi 20% të fondit limit që oferton operatori**, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës).

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

Pika 2.3.2: Operatori Ekonomik Ofertues duhet të vërtetojë që ka të paktën 2 (dy) Inxhinierë në stafin e tij të trajnuar për aparaturën e përcaktuar në lot 2 , të cilët do të kryejnë shërbimin e furnizim - vendosjes së pajisjes objekt prokurimi, riparimin apo ndërrimin e pjesëve të këmbimit dhe trajnimin e personelit për përdorimin e pajisjeve objekt prokurimi.

Për këtë OE duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese për secilin nga stafi më sipër:

- CV-në e inxhinjerit;
- Diplomë e inxhinjerisë;

Çertifikatat/dëshmitë e trajnimit për pajisjet objekt prokurimi, lëshuar nga kompania prodhuese ose ekuivalentet e këtyre çertifikimeve lëshuar nga autoritete të autorizuar/çertifikuara për dhënien e tyre,

- Kontratë pune/ shërbimi e vlefshme.

****Shënim:*** Ky kriter në fazën e ofertimit të operatorëve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, OE i kualifikuar i pari, duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri. OE i kualifikuar i pari, duhet të paraqesë dokumentacionin e përcaktuar më lart origjinal ose kopje të noterizuar të tij, në zbatim të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Më konkretisht, në nenin 40, pika 5/b dhe c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, përcaktohet:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

d) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

e) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

f) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Personeli i Operatorit ekonomik i nevojitet Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar realizimin e plotë të objektit të këtij prokurimi.

(Shënim - Specifikoni proceset, veprimtaritë apo shërbimet që kërkohen për realizimin e kontratës së furnizimit të mallrave, si dhe numrin e punonjësve të nevojshëm në çdo rast, bazuar në analizën e kryer).

Gjithashtu, argumentimi i Komisionit Ad-Hoc: Eshtë menduar stafi minimal prej 2 inxhinjera të nevojshëm për realizimin e prokurimit, pasi me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së Kontratës, ofrimi i shërbimit dhe mundësia e pjesëmarrjes në ofertim e sa më shumë Operatorëve Ekonomikë.

Shënim: Autoriteti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.2.

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

Pika 2.4.1: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga prodhuesi (MAF) / ose / Autorizim nga Distributori i Autorizuar (DAF) (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), për të garantuar mirëmbajtjen cilësore, të sigurtë dhe pjesë origjinale të pajisjeve mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi. Autorizimi të jetë i vlefshëm në hapjen e ofertave dhe gjatë zbatimit të Kontratës. Autorizimi duhet të jetë original i përkthyer dhe/ose fotokopje e noterizuar.

Argumentim: Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje në pikat 2 dhe 4 të nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku është e cituar: 5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues(ref. Vendimit të KPP nr. 353/2014).

Si dhe, gjithashtu ky kriter u vendos në mbështetje të Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Datë 20.03.2018 të Agjensisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore “Rekomandim mbi hartimin e kritereve për kualifikim në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, dhe me qëllim zotërimin e reputacionit dhe besueshmërisë për zbatimin e kontratës. Afati i vlefshmërisë së autorizimit vendoset në përputhje me kohëzgjatjen e MK. Keto kërkesa dhe vecanerisht lidhja me distributorin, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës, pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

Pika 2.4.2:

a)Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë një **deklarate ku te percaktohet kompania prodhuese, vendi i origjines dhe certifikimet e produkteve objekt prokurimi, si dhe**

b)Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqese një deklaratë, me anë të së cilës të deklarojë se **Garancia të paktën 2** (dy) vite nga data e instalimit dhe vendosjes në funksion të plotë të pajisjes si dhe se në rast të difektit të ndodhur gjatë kësaj periudhe, Operatori Ekonomik Ofertues do të zgjidhë difektin menjëherë dhe nëse duhen pjesë këmbimi për riparim ato të jenë origjinale nga Prodhuesi dhe me garanci jo më pak se 2 (dy) vjet.

c)Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqese një deklaratë, me anë të së cilës të deklarojë se artikujt objekt prokurimi, do të jenë të reja dhe të pa përdorura, kompatibel, si dhe të kenë të stampuar markimin CE ose FDA.

d) Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqese një **autodeklaratë**, ku të garantojë se me lidhjen e kontratës pajisja do të regjistrohet pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM) në përputhje me ligjin nr. 89, datë 17.07.2014 “Për pajisjet mjekësore” dhe se certifikata e regjistrimit do të vihet në dispozicion të AK.

e)Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqese një deklaratë, ku merr përsipër trajnimin e personelit përdorues të pajisjes për të paktën 5 ditë pune, , pas instalimit te pajisjes objekt prokurimi.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Argumentim: shkronat a-e të pikës: 2.4.2 janë vendosur në zbatim të: këto kriteret janë vendosur nga Komisioni i Përlllogaritjes së Fondit limit dhe Specifikimeve Teknike me shkresën nr. ____ prot., datë _____, si dhe është miratuar nga anetarët e Njesise se Prokurimit qe ka specialitetin perkatese ne lidhje me kriteret teknike, ne perputhje me piken 4 te nenin 77 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, ”Për prokurimin publik”, ”, neni 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, me nenin 36 dhe nenit 79 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, ”Për prokurimin publik”, si dhe ne Nenin nr.13 te Ligjit Nr. 89/2014 për ”Pajisjet Mjekësore” .

Pika 2.4.3.

d. Për te gjithë artikujt të paraqiten katalogje te prodhuesit, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull të përcaktuar në tabelë (*pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohet, duhet të jenë në gjuhën shqipe ose anglisht*).

e. Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor **(te markuara sipas artikullit)** te përcaktuar ne formularin e ofertes.

f. Katalogjet do pranohen ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit si dhe fizikisht gjatë dorëzimit të dokumentacionit nga OE i klasifikuar fitues.

Paraqitja e katalogjeve per te gjithë artikujt qe jane objekt prokurimi, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perpuethshmerise se paisjeve mjekesore qe operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike te percaktuara ne DST ne Shtojcen 6.

Pika 2.4.4. Ofertuesi duhet te paraqese nje autodeklarate ku deklarone se pajisjet do te jene te shoqeruara me manualin e perdorimit, manualin e vendosjes sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe manualin e servisit/sherbimit.

OE duhet të paraqesi deklarata se pajisjet do te jene te shoqeruara me manualin e perdorimit, manualin e vendosjes sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe manualin e servisit/sherbimit, eshte kerkuar ne menyre qe pajisjet mjekesore te perdoren dhe te mirembahen nga stafi mjekesor sipas rekomandimeve te prodhuesit ne menyre qe te shmangen cdo lloj problematike qe mund te lind nga perdorimi ne menyre jo korrekte i ketyre pajisjeve.

Argumentimi: Pika 2.4.3. dhe Pika 2.4.4. eshte vendosur nga anetari i Njesise se Prokurimit qe ka specialitet perkates ne lidhje me kriteret teknike si dhe eshte ne perputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se:[...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].*

Paraqitja e katalogjeve per te gjithë artikujt qe jane objekt prokurimi, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perpuethshmerise se paisjeve mjekesore qe operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike te percaktuara ne DST ne Shtojcen 6.

Pika 2.4.5. Operatori ekonomik duhet te paraqese **oferten teknike**, per pajisjen objekt prokurimi bashke me aksesoret perkates, ne forme table, ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut te pajisjes / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatese per produktet.

Ne kete kontekst eshte kerkuar dhe oferta teknike, me ane te se ciles do te behet e mundur verifikimi me i sakte i artikujve te ofertuar, specifikimeve te tyre, origjina, konformiteti etj me dokumentacionin mbeshketes te paraqitur nga ofertuesi.

Argumentimi: Kriteri i vendosur në pikën 2.4.5, eshte vendosur nga anetari i Njesise se Prokurimit qe ka specialitet perkatese ne lidhje me kriteret teknike si dhe eshte ne perputhje me **piken 1 te nenit 36 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”,** ne tecileneshte e percaktuar se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specififikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specififikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi..

Gjithashtu ky kriter është ne perputhje me pikën 2 të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: 2. *Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

Ne kete kontekst është kërkuar dhe oferta teknike, me ane të se ciles do të bëhet e mundur verifikimi me i sakte i artikujve të ofertuar, specifikimeve të tyre, origjina, konformiteti etj me dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga ofertuesi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim për operatorët ekonomikë:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”

Gjithashtu risjellim në vëmendje se:

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes për keto pika do të jetë kusht skualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor mund të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi.

Në çdo rast, AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më lart, ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Shënim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të

justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përkthuhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- **Loti 1 Furnizim- Vendorsje Aparatura Laparoskopie për Kirurgjinë Abdominale Specifikimet Teknike**

KOLONË LAPAROSKOPIE FULL HD PËR KIRURGJINE ABDOMINALE

Videoproçesori

Me cilësi imazhi Full HD dhe me sistem të integruar dokumentimi.

Njësia e kontrollit minimumi dy hyrje kamerash.

Të lidhet me endoskop të ngurtë dhe fleksibël (fibro- dhe video-endoskope) si dhe video laringoskope

Me teknika për përmirësimin e imazhit.

Me aftësi për kontrollin e ndriçimit, zmadhimin e imazhit (zoom), për rrotullimin dhe pasqyrimin e tij.

Kalimi midis imazheve të kamerave me prekjen e një butoni.

Ruajtja e të dhënave, imazheve dhe filmimeve në formatin Full HD në kujtesën e brendshme me kapacitet të pakten 40GB

Aftësi për transferimin e të dhënave dhe filmimeve në USB/CD.

Pajisur me porte RJ45 për komunikim në rrjet

Pajisur me tastierë për regjistrimin e të dhënave të pacientit.
Të lidhet me printerin për printim të drejtpërdrejtë.
Dalje HDMI/DVI për monitor dhe regjistruar të jashtëm me rezolucion 1080p.

Kamera endoskopike

Kompatibël me video-procesorin të ofruar më sipër.
Të marre imazhe progresive në formatin Full HD.
Me fokus të rregullueshëm.
Lehtësisht e manovrueshme me përmasa dhe peshë maksimale 130 gr.
Me dy butona lehtësisht të programueshëm.
E sterilizueshme.
Gjatësia e kabëllit minimumi 300 cm.

Monitor mjekësor, Full HD

Kompatibël me video-procesorin e imazhit.
Teknologjia TFT/LCD ose LED.
Madhësia e ekranit minimumi 27".
Rezolucioni minimumi 1920x1080 pixel.
Ndriçimi maksimal minimumi 850 cd/m2.
Kontrasti minimumi 1000:1.
Këndi i shikimit minimumi 178° H / 178° V.

Burimi i dritës LED

Të jetë për ndërhyrje kirurgjikale laparoskopike, etj.
Ndriçimi i krahasueshëm minimum me llampë Xenon 300Ë.
Teknologji LED me jetëgjatësi minimumi 30,000 orë pune.
Me ekran tregues për orët e punës të llampës dhe mesazhe funksionimi.
Temperatura e ngjyrës 6000-6500K.
Kontroll manual dhe automatik i ndriçimit.
Komunikim me sistemet e kamerave.

Kabli i dritës

I përshtatshëm për lidhjen e optikave me burimin e dritës.
Diametri 4.5-5 mm.
Gjatësia minimumi 300 cm.
I sterilizueshëm.

Elektrobisturi me frekuencë të lartë

Gjenerator me frekuencë të lartë me një game të gjere funksionesh monopolarë dhe bipolarë në disiplina të ndryshme kirurgjikale
Fuqia maksimale në modalitetin monopolar dhe bipolar maksimumi 400Ë
Me dy dalje monopolarë dhe dy dalje bipolarë
Me ekran me ngjyra min. 8.4", me prekje për shfaqjen dhe vendosjen e parametrave të punës
Me min. 200 programe të gatshme për procedura të ndryshme klinike dhe mundësi shtimi programesh të personalizuar

Me njohje automatike te instrumentave per optimizim te parametrave
Modalitet per optimizim parametrash per instrumenta laparoskopike bipolare
Fuqia maksimale ne vaporizim bipolar jo me pak se 400W
Me monitorim te rrjedhjeve te rrymes HF dhe elektrodes neutrale
Furnizuar me elektrode neutrale shume perdorimeshe silikoni dhe pedal dysh per komandim

Insuflatori me CO2

I pershtatshem per procedura kirurgjikale, me fluks te larte.
Pajisur me sistem per evakuimin te tymit ne kombinim me elektrobisturine e mesiperme.
Me ekran me ngjyra me prekje, per shfaqjen dhe vendosjen e parametrave te punes.
Fluksi minimumi 50 litra ne minute, i rregullueshem.
Me ngrohje dhe lageshtim te gazit per te minimizuar traumat tek pacienti
Minimumi dy menyra pune, per te rritur dhe femijë.
Me monitorim te presionit endokavitar, te rregullueshem nga 1-30 mmHg.
Aftësi per rikuperim te shpejte te humbjeve te gazit.
Me sistem vete-testimi dhe sigurie ndaj mbi-presioneve.
Te tregojë fluksin e gazit dhe konsumin e tij.
Me funksion per largimin e gazit dhe filtrimin e substancave te demshme te pakten 99.999%
Te lidhet me sistemin qendror te shperndarjes se CO2 me presion te ulët dhe me bombul me presion te larte.
Alarme per mbi-presion gazi, mungese furnizimi etj.
Pajisur me tub furnizimi gazi me minimum 100 cm.
Furnizuar me te pakten 10 tuba insuflimi me ngrohje dhe lageshtim, me filter, te paketuuar individualisht.

Karroce endoskopike

E pershtatshme per pozicionimin e pajisjeve te endoskopise dhe kamerës.
E levizshme, me rrota te kthyeshe me frena.
Me 4 ndarje per vendosjen e pajisjeve dhe nje sirtar.
Pajisur me furnizues energjie per pajisjet e ofruara.
Furnizuar me mbajtësen e monitorit dhe mbajtëse per bombulen e gazit.
Dimensionet: 75 x 80 x 150 cm ($\pm$ 5 cm).

Sistem per irrigim dhe aspirim

Sistem irrigimi dhe thithjeje per perdorim ne kirurgji laparoskopike
Ekran me prekje per kontrollin elektronik te presionit dhe fluksit te irrigimit.
Rregullimi i presionit te irrigimit minimumi 400 mmHg.
Rregullimi i fluksit te irrigimit minimumi 2000 ml/min.
Sistem thithjeje i rregullueshem, i pajisur me filter hidrofobik dhe me dy shishe aspirimi te sterilizueshme, minimumi 3 litra.
Rregullimi i presionit te aspirimit min. -0.8bar
Set tubash aspirimi, i sterilizueshem.
Sistemi duhet te punoje me rryme elektrike 220 V 50 Hz.

- **Loti 2 Furnizim- Vendosje pajisja mjekësore CT Scanner**

Specifikimet Teknike

1.CT Scan 128 Slice

Sistem CT Scanner për trupin e plotë duke përfshirë opsionet për ekzaminim kardiak, torakal, abdominal, neuro, muskuloskeletor dhe vaskular.

Të përfshijë algoritme për reduktimin e dozës si dhe algoritme efektive për reduktimin e artefakteve.

Gantry:

Të ketë një diametër: ≥ 70 cm

Koha më e shpejtë e rrotullimit të dorezës (360°) të jetë 0.40 sekonda ose më shpejt

SFOV më i madh të jetë ≥ 50 cm

Të përfshijë sistem komunikimi dypalësh me pacientin

Të ketë 'rreshtim me lazer'

Shtrati i pacientit:

Gjatësia e diapazonit të lirë të skanimit duhet të jetë ≥ 180 cm.

Lartësia më e ulët e tavolinës duhet të jetë maksimumi 550 mm.

Shpejtësia e lëvizjes gjatësore duhet të jetë në diapazonin rreth 5 mm/s deri në 250 mm/s ose më mirë.

Kapaciteti mbajtës që tavolina mund të përballojë nuk duhet të jetë më pak se 200 kg.

Saktësia e pozicionimit duhet të jetë afërsisht ≤ 2 mm

Gjeneratori dhe tubi i rrezatimit X:

- Të ketë një fuqi maksimale prej ≥ 80 kE (nominale)
- Diapazoni i tensionit të tubit duhet të jetë të paktën nga 70 kV deri në 135 kV
- Numri i niveleve të zgjedhshme të kV duhet të jetë ≥ 5 nivele
- Kapaciteti nominal i nxehësisë së anodës duhet të jetë minimumi 8 MHU
- Të mundësojë ≥ 100 sekonda skanim të pandërprerë

Sistemi i skanimit dhe detektorëve:

- Numri i prerjeve në një skanim aksial duhet të jetë 128
- Trashësia minimale e prerjes 0.625 mm ose më mirë
- Të ketë teknika për reduktimin e dozës
- Të ketë algoritme / programe për ruajtjen e dozës
- Të përfshijë ndjekjen e bolusit, të mund të nisë automatikisht skanimin me injeksion bolusi
- Të mundësojë të paktën deri në 60 sekonda skanim të pandërprerë

Rindërtimet:

- Matrica e rindërtimit duhet të jetë minimumi 512 x 512
- Matrica e ekranit duhet të jetë minimumi 1024 x 1024
- Shpejtësia e rindërtimit të jetë 80 FPS ose më mirë
- Rindërtimi i trashësisë më të hollë të prerjes të jetë të paktën 0.625 mm
- Të mundësojë reduktimin e artefakteve metalike
- Të ketë filtrin e projektimit nga prapa FBP (filter back projection)
- Të mundësojë korrigjimin inteligjent të lëvizjes për përfitime kardiake
- Rezolucioni më i lartë i mundshëm kohor (vlera më e ulët në ms) të jetë maksimumi 70 ms

- Rezolucioni hapësinor në aksin Z duhet të jetë ≥ 0.45 mm
- Të ketë një paketë të plotë vaskulare:
 - Të ketë protokolle për analizë vaskulare si vlerësimi i stenozës, aneurizmës.
 - Të mundësojë rindërtim 3D dhe modalitet endo.
 - Të mundësojë njohjen e aterosklerozës:
 - Të përfshijë licencat përkatëse

Të ketë paketën neurologjike:

- Të ketë protokoll 'heqjeje' të kockës për imazheri vaskulare (gjithashtu për ekzaminime pulmonare dhe kardiake).
- Të përfshijë licencat përkatëse.

E gjithë 'softueri' duhet të jetë në dispozicion me procedurë raportimi, eksportim sipas formateve DICOM, pdf, rtf, etj., për të mundësuar transferimin e imazheve për tele-radiologji në regjistrat elektronikë shëndetësorë, në departamente të tjera mjekësore ose spitale të tjera.

Paneli i kontrollit

Monitori i parë të ketë kapacitet Full HD, $\geq 19"$

Të jetë ekran ngjyrë IPS ≥ 8 -bit, anti-shkëlqim, me opsion DVI-D ose lidhje të ngjashme

Monitori i dytë duhet të ketë kapacitet $\geq 19"$, 2 megapiksel, ekran IPS me ngjyra ≥ 10 -bit, anti-shkëlqim, me kapacitet DVI-D ose lidhje të ngjashme.

Të ketë një procesor AMD ose Intel me ≥ 4 bërthama

Të ketë ≥ 16 GB DDR RAM

Karta grafike të jetë në gjendje të lidhet me 2 ekrane njëkohësisht

Kapaciteti i ruajtjes të jetë ≥ 500 GB HDD

Të lidhet me një lidhje Ethernet Gigabit

Të mundësojë arkivimin e DVD-ve me të dhënat e pacientit dhe imazhe grafike

Të ketë një portë USB

Ndërfaqja e kontrollit të skanimit të përfshijë Intercom dhe altoparlant

Stacion i veçantë për përpunim pasues (në dhomën e mjekut)

- Stacioni i përpunimit duhet të shoqërohet me 2 (dy) monitorë Full HD $\geq 19"$
- Të ketë kapacitet ≥ 16 Gb RAM
- Të ketë kapacitet prej ≥ 500 Gb HDD memorie të brendshme
- Të ketë sistem regjistrimi DVD për të dhënat e pacientit dhe imazhet grafike.
- Monitori i parë të jetë $\geq 1,024 \times 1,980$ piksel dhe ≥ 19 inç
- Monitori i dytë duhet të jetë ≥ 19 inç . Të jetë monitor i klasës mjekësore
- Të ketë një procesor AMD ose Intel ≥ 4 bërthama
- Kapaciteti RAM të jetë ≥ 16 GB DDR RAM .
- Karta grafike të mund të lidhet me 2 ekrane njëkohësisht
- Kapaciteti i ruajtjes të jetë ≥ 200 GB .
- Të mundësojë lidhje Gigabit Ethernet
- Të mundësojë regjistrim DVD dhe arkivim të të dhënave të pacientit dhe imazheve grafike
- Paketat e përpunimit pasues dhe analizës siç përshkruhen duhet të jenë të gjitha të disponueshme në këtë stacion pune.
- Të mundësojë rindërtim multiplanar direkt, rindërtim voluminoz, perfuzion CT për multi-organe

Lidhja DICOM 3.0 ose më mirë:

Të ofrojë shërbime ruajtjeje, Ofrues i klasës së shërbimit, Përdorues i klasës së shërbimit, Printim, Angazhim për ruajtje, Listë pune modaliteti, MPPS.

Set aksesorësh për CT:

- Të ketë set fantomësh QC
- Të ketë jastëkë për pozicionimin e pacientit
- Të ketë mbështetje për krahun e pacientit
- Të ketë një tabaka (tabaka tavoline)

Aksesorët që duhet të përfshihen:

E gjithë softueri duhet të jetë origjinal dhe i licencuar zyrtarisht, pa tarifa/suskriptime shtesë të kërkuara për funksionimin e pajisjes dhe stacionit diagnostik gjatë ciklit jetësor dhe përdorimit

Të gjithë kabllo, aksesorët, pajisjet lidhëse që lejojnë montimin e sistemit dhe që lejojnë funksionimin e saktë dhe të sigurt të sistemit me të gjitha funksionet e kërkuara

Të gjitha materialet dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e testimeve dhe verifikimeve duhet të sigurohen nga ofertuesi gjatë instalimit

Lidhja elektrike duhet të jetë sipas standardeve shqiptare (duke përfshirë lidhjen trefazore për pajisjen kryesore dhe 220-240 V AC njëfazore për stacionin e punës)

Gjuha e ndërfaqes dhe manualeve në anglisht; dhe në shqip.

Rrjeti elektrik dhe mbrojtja:

- Të funksionojë në 230-240 VAC, 50 Hz ose trefazor 380-415 VAC, 50 Hz me transformator të furnizuar nga furnizuesi nëse tensioni është i ndryshëm.
- Të mundësojë kompensim automatik të tensionit të linjës prej të paktën $\pm 10\%$.

2. Injektor kontrasti, i lëvizshëm

- Injektori i kontrastit të jetë i komanduar në distancë me dy koka dhe presion të lartë për të sinkronizuar me sistemin CT
- Dy shiringa të mund të ngarkohen dhe përdoren njëkohësisht
- Shkalla e rrjedhjes për secilën shiringë duhet të jetë në diapazonin 0.1 deri në 10 mL/sek
- Të ketë volumet përkatëse: 50 ml, 100 ml, 200 ml
- Të ketë cilësime / bazë të dhënash për kontrastin dhe parametrat e pacientit, etj.

3.U.P.S

UPS për autonominë e gjithë pajisjes CT Scanner për 10 min

Tipi i U.P.S : Double conversion line

Tensioni në hyrje të pajisjes : 400 trifazor

Fuqia e shprehur në E : 120 KË

Fuqia e shprehur në VA : 120KVA

Rryma maksimale në hyrje 207A

Rryma maksimale e qendrueshme për një kohë të shkurtër : 10kA

Shtrembërimet harmonike të hyrjes : Më pak se 3% për ngarkesë të plotë

Faktori i fuqisë në hyrje për ngarkesë të plotë : 0.99

4.Defibrilator

Defibrilator bifazik me fuqi 200J

Duhet të integrojë defibrilimin, monitorimin, AED .

Të ketë funksion kardioversioni

Të jetë i pajisur me printer

Të ketë ekran prej të paktën 8.4"

Të jetë i pajisur me bateri të brendshme

Bateria duhet të jetë në gjendje që të sigurojë të paktën 200 goditje me të paktën 200J për secilën goditje

Koha e ngarkimit deri në 200J nuk duhet të jetë më e madhe se 8s

Brezi matjes së EKG duhet të jetë të paktën nga 15-300 rrahje për minutë

Ritmi kardiak : 20-300bpm (+/-2%)

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

- Loti 1 Furnizim- Vendorsje Aparatura Laparoskopie për Kirurgjinë Abdominale
- Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
Nr. 1	KOLONË LAPAROSKOPIE FULL HD PËR KIRURGJINE ABDOMINALE	1	QSRT “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.	2 muaj nga data e lidhjes së Kontratës.

Afati i Realizimit të procedurës:

4 muaj nga data e lidhjes së Kontratës.

- Loti 2 Furnizim- Vendorsje pajisja mjekësore CT Scanner

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
Nr. 1	CT Scan 128 Slice	1	QSRT “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.	2 muaj nga data e lidhjes së Kontratës.
Nr. 2	Injektor kontrasti, i lëvizshëm	1	QSRT “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.	2 muaj nga data e lidhjes së Kontratës.
Nr. 3	U.P.S	1	QSRT “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.	2 muaj nga data e lidhjes së Kontratës.
Nr. 4	Defibrilator	1	QSRT “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.	2 muaj nga data e lidhjes së Kontratës.

Afati i Realizimit të procedurës:

2 muaj nga data e lidhjes së Kontratës.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP:

“38/b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë” si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “për mallrat që do të prokurohen, autoriteti/enti kontraktor parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.”

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sasia dhe Grafiku i levrimit janë vendosur në bazë të shkresës nr. prot., datë _____.2025 dhe referuar Relacionit për argumentimin e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike Shkresës ”Përlllogaritje fondi limit për procedurëm e prokurimit me objekt: **“Furnizim-Vendosje Pajisje Mjekësore Aparatura Laparoskopie për Kirurgjinë Abdominale dhe Furnizim-Vendosje pajisja mjekësore CT Scanner,e ndare në dy lote**”, me nr ____/____ prot, datë ____/____/____ si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38/b të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 41, pika 1-7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, si dhe shkresën nr____., **date** _____.2025 të Titullarit të Përgjithshëm me nr 280/____ prot datë _____.2025, si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38/b të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik, si dhe piken 1 te nenit 40 te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 “*Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik*”, në të cilën gjejmëe të përcaktuar se: 1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.

NJËSIA E PROKURIMIT: